



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE S. KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SER. OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljenut/Prodato Received/Delivery	18.01.2021	1	viti god year
Organ /Njesta Organ /Jedinitca Org./Unit	Nr Prot Bil Prot Prot No	Shtojca Pilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHUK	199/2021		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.391/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Ilire Mehmeti-Shaqiri Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.391/2020 të datës 04.12.2020 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga "Rexhep Bislimi", Komuna e Ferizajt, kundër heshtjes administrative të Qeverisë së Republikës së Kosovës/Ministritë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës/mos vazhdim i kontratës së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur me datë 18.01.2021, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.391/2020 e datës 04.12.2020, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi më datë 04.12.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 2946/2020 të regjistruar me numër A.nr.391/2020, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të Qeverisë së Republikës së Kosovës/Ministritë së Punëve të Brendshme, lidhur me mos vazhdimin e mandatit si Sekretar i Përgjithshëm i Ministritë së Financave.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 09.12.2020 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Sekretariati Koordinues në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Këshilli më datë 18.12.2020 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Zyra e Kryeministrit, se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën numër të protokollit 2946/2020 të datës 04.12.2020 të regjistruar me numër A.nr.391/2020 në Këshillin e Pavarur

Mbikëqyrës për shërbim Civil të Kosovës: Njoftimin e Kryeministrit përmes rrjeteve sociale lidhur me mbarimin e mandatit të zyrtarëve në pozita të larta publike: Shkresën e datës 14.04.2020 drejtuar Kryeministrit të Republikës së Kosovës: Kërkesën e datës 12.05.2020 drejtuar Këshillit për Pozita të Nivelit të Lartë Drejtues: Kërkesën e datës 20.08.2020 për ri caktim/sistemim, drejtuar Kryeministrit të Republikës së Kosovës: Vendimin Nr.03/03 të datës 19.02.2020 të QRK-së: Njoftimin e MPB-së të datës 05.10.2020: Njoftimin e MPB-së të datës 28.08.2020 lidhur me pozitat e kategorisë së lartë drejtuese: Emalin e datës 05.08.2020: Emalin e datës 04.08.2020: Mesazhin telefonik: Kërkesën për përgjigje në ankese të datës 09.12.2020 me numër të Protokollit 3039/2020: Përgjigjen në ankesën e datës 18.12.2020 me numër të protokollit 3200/2020: Vendimin Nr.09/149 të datës 17.07.2017 për vazhdim të mandatit: Vendimin Nr.09/20 të datës 22.06.2011: Vendimin Nr.07/194 të datës 23.07.2014: Emalin e datës 06.01.2021: Emalin e datës 11.01.2021: Vendimin me numër të protokollit 878 të datës 10.07.2020: Vendimin me numër të protokollit 165 të datës 21.02.2020.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e pa lejuar sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se ankuesi në bazë të Vendimit Nr.09/20 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me datë 22.06.2011 është emëruar në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Financave, me mandat tre (3) vjeçar. Përmes Vendimit Nr.07/194 të datës 23.07.2014 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ankuesit i është vazhduar mandati për tre (3) vite, ndërsa me Vendimin Nr.09/149 të datës 17.07.2017, ankuesit i është vazhduar mandati edhe për tri (3) vite tjera, deri më datë 17.07.2020, në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Financave. Emërimi i ankuesit në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm është bërë sipas dispozitave të nenit 15 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në shkresat e lëndës, ka konstatuar se Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 19.02.2020, ka nxjerr Vendimin Nr.03/03 të datës 19.02.2020, për kalimin në listë rezervë të Sekretarëve të Përgjithshëm të Ministrive të cilat janë prekura nga riorganizimi sipas Vendimit Nr.07-V-005 të datës 03.02.2020 të Kuvendit të Republikës së Kosovës për Zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Pjesë e listës rezervë është edhe Sekretari i Ministrisë së Financave, në këtë rast ankuesi.

Pas Vendimit Nr.03/03 të datës 19.02.2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Kolegji bazuar në shkresat e lëndës ka gjetur se ankuesi me datë 14.04.2020, 12.05.2020 dhe 20.08.2020 i është drejtuar Qeverisë së Republikës së Kosovës, me kërkesë për ri caktim/sistemim.

Ankuesi, duke marr parasysh se nuk ka pranuar përgjigje në kërkesat e tij drejtuar Qeverisë së Republikës së Kosovës, me datë 04.12.2020 ka parashtruar ankesën me numër protokollit 2946 të regjistruar me numër A.nr.391/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me mos rizgjedhjen apo caktimin në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave sipas Ligjit për Shërbimin Civil, rrjedhimisht pamundësinë për vazhdimin e mandatit sipas Ligjit për Zyrtarët Publikë, duke kërkuar që Këshillit të obligoje Ministrinë e Punëve të Brendshme që të bëjë vlerësimin e performances dhe të propozohet në Qeveri për vende për ri zgjatjen e mandatit sipas dispozitave të Ligjit për Zyrtarët Publik.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka konstatuar se nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta



këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil. Ndërsa Ligji Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 127 përcakton se: 1. Ankesa duhet të parashtrahet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ; 2. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrahet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.

Andaj, duke u bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht Vendimin Nr.09/149 të datës 17.07.2017 ku shihet se ankuesit i ka përfunduar mandati me datë 17.07.2020, Vendimin Nr.03/03 të datës 19.02.2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për kalimin e ankuesit në listë teprice, si dhe Kërkesën e ankuesit të datës 14.04.2020, 12.05.2020 dhe 20.08.2020, drejtuar Qeverisë së Republikës së Kosovës, për ri caktim/sistemim, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave vlerëson se ushtrimi i ankesës nga ankuesi me datë 04.12.2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, duke u bazuar në nenin 129 paragrafi 1 nen paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.391/2020

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse



Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit;
- Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme
- Ministrit të Ministrisë së Financave;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave;
- Arkivët të KPMSHCK-së.

